

Shenjtori i ditës: Thekla, dëshmorja e parë - Oshënar Siluan Athoniti



image not found or type unknown

E enjte, 24 shtator 2020 – Shenjtori i ditës

Thekla, dëshmorja e parë. Oshënar Siluan Athoniti. Shën Persida. Oshënar Kopri.

– Thekla, dëshmorja e parë –

Shën Thekla ishte nga qyteti i Ikoniumit në Azinë e Vogël. Ajo ishte vajza e një pagani të pasur që quhej Theokli. Thekla u fejua në moshën 18-vjeçare me një burrë të quajtur Thamiris, i cili e donte tej mase. Ishte koha kur shën Pavli erdhi nga Antiokia, qëndroi në Ikonium, në shtëpinë e Onesiforit, një fqinj i Theklës dhe u mësonte aty fjalën e Perëndisë.

Të gjithë atyre që e dëgjonin me gëzim të madh, ai u thoshte: “Të bekuar janë të pastrit në zemër, sepse ata do të shikojnë Perëndinë. Të bekuar janë ata që ruajnë pastërtinë e mishit të tyre, sepse ata do të jenë tempulli i Perëndisë. Të bekuar janë ata që kanë hequr dorë nga kjo botë, sepse ata do të pranohen nga Perëndia. Të bekuar janë ata që e kanë frikë fjalën e Perëndisë, se ata do të ngushëllohen. Të bekuar janë ata që përqafojnë urtësinë e Jisu Krishtit, se ata do të quhen bijtë e të Shumëlartit. Të bekuar janë ata që kanë ruajtur pagëzimin e tyre, se ata do të gjejnë prehje me Atin dhe Birin. Të bekuar janë ata që kanë kuptuar njohjen e Jisu Krishtit, se ata do të jenë në dritë. Të bekuar janë ata që kanë hedhur tej dukjet e jashtme të kësaj bote për hir të dashurisë së Perëndisë, se ata do t’i gjykojnë engjëjt dhe do të lavdërohen në të djathtë të Atit. Të bekuar janë trupat e të virgjërve, se fjala e Atit do t’i justifikojë ata në ditën e Birit të Tij dhe do të gëzojnë prehje të përjetshme”.

Kur dëgjoi fjalët hyjnore të Pavlit, pas një perdeje, ku kishte qëndruar e fshehur për tri ditë me radhë, Thekla, duke ndjerë gëzim të jashtëzakonshëm, u tërhoq pa kthim drejt besimit. Kur panë se ajo nuk mendonte më asgjë tokësore dhe ishte dhënë me shpirt pas fjalëve të atij të huaji që këshillonte shenjtërimin e martesës, Theokli dhe Thamirisi u shqetësuan tej mase. I tërë qyteti ndodhej në turbullim të madh, prandaj edhe Pavlin e arrestuan dhe e çuan te guvernatori, i cili urdhëroi ta lidhnin me zinxhirë dhe ta fusnin në burg. Atë natë Thekla doli për ta kërkuar shën Pavlin dhe kur mësoi se ndodhej në burg, i shkoi atje, ia fali gardianit byzylykët e saj të artë dhe qëndroi në këmbët e Pavlit, duke puthur zinxhirët e tij, ndërsa ai i

fliste asaj për veprat e fuqishme të Perëndisë.

Kur Theklën e gjetën në shoqërinë e Pavlit, të dy i çuan përpara guvernatorit. Meqë ajo nuk u përgjigjej pyetjeve të tij, nëna e Theklës thirri me të madhe: “Digjeni këtë armike të martesës në mes të amfiteatrit si një shembull për të gjitha gratë”. Për ta kënaqur turmën, guvernatori e rrahu Pavlin me kamxhik dhe e çoi jashtë qytetit, kurse Theklën e dënoi të digjej e gjallë. E çuan të zhveshur në vendin e ekzekutimit, ndërsa djem dhe vajza të reja mblodhën dru për zjarrin. Atëherë, Thekla pa Shpëtimtarin t’i shfaqej me pamjen e Pavlit, dhe u mbush me fuqinë e Tij hyjnore. Duke e armatosur veten me shenjën e Kryqit, ajo u ngjit sipër turrës së druve. Flakët u lartësuan, por atë nuk e prekën. I prekur nga dashuria e shenjtores, Perëndia dërgoi shi qiellor për t’i qetësuar flakët, duke e mbushur amfiteatrën me ujë. Në ato çaste Pavli qëndronte bashkë me Onesiforin dhe shtëpinë e tij, i fshehur në varr jashtë qytetit. Thekla u soll nga Perëndia pranë tij atje dhe të dy u larguan për në Antioki.


Kur ata hynë në qytet, Aleksandri një nga fisnikët e qytetit, i mahnitur nga bukuria e Theklës, rendi ta puthë në mes të rrugës. Por ajo e mbrojt veten e saj me forcë, duke i grisur mantelin dhe duke i prishur kurorën. Për t’u hakmarrë nga ky veprim, Aleksandri e dorëzoi te guvernatori i qytetit. Ky i fundit e dënoi me vdekje te bishat e egra. E lidhën përpara një luaneshe, që nuk bëri asgjë veçse i lëpinte këmbët me nderim për virgjërinë e saj. Ditën tjetër, asaj i lëshuan shumë kafshë të egra, por asnjë prej tyre nuk e preku, sepse e mbronte luanesha me këmbëngulje. Kur i vunë një kazan të mbushur me ujë dhe gjarpërinj të rrezikshëm, duke qenë e gatshme për një mundim të ri, shenjtorja thirri: “Tani është koha për të marrë banjën e rilindjes”. Dhe, pasi u hodh në ujë, thirri: “Në emër të Jisu Krishtit, po e pagëzoj veten time në ditën time të fundit”. Një rrëqethje e përshkoi turmën nga mendimi se një vajzë aq e hijshme do të gllabërohej nga zvarranikët, por në atë çast që u zhyt në ujë, shkëlqimi i një drite i goditi kafshët dhe këto dolën të ngordhura në sipërfaqe; gjithashtu një re e dendur mbuloi lakuriqësinë e shërbëtores së Perëndisë.

Thekla u la në mëshirën e kafshëve të tjera, edhe më të egra akoma, por gratë e qytetit, të fyera jashtë mase nga dënimi i saj i paligjshëm, nisën të protestojnë duke bërë rrëmuje të madhe. Disa hodhën barishte dhe të tjera nard, kasi dhe kanellë, duke e mbushur amfiteatrën me parfum, kështu që kafshët u trullosën dhe nuk i bënë gjë shenjtores. Pastaj Theklën e lidhën në brirët e dy buajve, të cilët i tërbuan me hekura të nxehtë. Por një zjarr ra nga qielli dhe i dogji litarët që e mbanin të lidhur pas buajve, kështu që shenjtorja nuk u dëmtua nga tërbimi i tyre. Duke parë se tërë ligësitë e tyre nuk sollën asnjë dëm te shërbëtorja e Perëndisë, guvernatori dhe Aleksandri e lanë të lirë.

Për disa ditë, Thekla qëndroi në shtëpinë e Trifenës, një zonjë e pasur e qytetit, që

e kishte pranuar atë si bijën e saj qysh nga fillimi i mundimeve. Por Thekla mendonte të gjente Pavlin përsëri dhe kështu shkoi në Mirë. Bashkë me shën Pavlin ajo u kthye në Ikonium për të shpallur veprat e Perëndisë. Aty gjeti Thamirisin të vdekur dhe nënën e saj të shurdhët për lajmin e mirë të shpëtimit, dhe për këtë arsye u largua për në Seleuci. Atje jetoi 72 vjet në asketizëm në Malin Kalamon, jo larg qytetit, duke bërë një luftë të egër kundër demonëve. Ajo u bë e famshme për mrekullitë që kryente. Duke pasur zili për famën e saj, doktorët paganë të qytetit dërguan disa të rinj të shthurur për ta çnderuar, por Perëndia u përkujdes që ta merrte shën Theklën dhe ajo u zhduk brenda shpellës së gurtë ku banonte.

Image not found or type unknown



* * * * *

– Oshënar Siluan Athoniti –

Ky i ri i Kishës u lind më 1866, në një familje të varfër në një fshat të Tambovit, provincë në Rusi. Që në fëmijëri pati një zell të madh për Perëndinë dhe vendosi ta ndjekë Atë kur tha: “Kur të rritem do shkoj të kërkoj Perëndinë në gjithë skajet e tokës”. Tregimet e asketëve dhe të shenjtorëve ndezën në zemrën e tij flakën e dashurisë për Perëndinë dhe duke u lidhur më kujtimin e Tij filloi të aspironte në jetën monakale. Por pak nga pak e humbi këtë zjarr dhe filloi të bënte një jetë të zakonshme si shumë të rinj, madje arriti në një çast sa për pak vrau një prej rivalëve të tij. Kjo ngjarje e ndihmoi të vinte në vete.

Disa ditë më vonë, në gjumë pa një ëndërr sikur një gjarpër hyri në gojën e tij dhe

dëgjoi zërin e Nënës së Zotit t'i thoshte me butësi: "Ashtu si ky gjarpër po të neverit, ashtu edhe mënyra jote e të jetuarit nuk më pëlqen!". I tronditur nga ky zbulim, ai ndërroi tërësisht drejtimin e jetës së tij dhe i udhëhequr nga një pendim i flaktë nuk mendonte veçse për Malin e Shenjtë dhe Gjykimin e fundit.

Më 1892, sapo mbaroi shërbimin ushtarak, u nis për në Malin e Shenjtë dhe filloi rishtarinë në manastirin e shën Pandelimonit, i cili ishte shumë i lulëzuar në atë kohë dhe numëronte afro dy mijë murgj. Nga rrëfimi i parë e i përgjithshëm mësoi se të gjitha mëkatet i ishin falur dhe rishtari i ri, i rrëmbyer nga gëzimi, harroi pendimin e thellë dhe kështu ra shumë shpejt në mendime mishtore. Pa përvojë në këtë luftë kundër mendimeve, u provua ashpër dhe u tundua nga mendimi për t'u kthyer në botë dhe të martohej. Por ati i tij shpirtëror e këshilloi që kurrë të mos pranonte sugjerime të tilla të mendimeve të liga dhe t'i largonte me lutjen e Jisuit kur këto i shfaqeshin në mendje.

Gjatë 45 viteve në manastir, shërbëtori i Perëndisë nuk pranoi asnjë mendim të keq dhe duke u kujtuar përherë për dashurinë e Perëndisë dhe për butësinë e Shpirtit të Shenjtë, ai kurrë nuk u zemërua. Filloi të mësonte shumë nga jeta shpirtërore nga ritmi i rregullt i jetës monakale, studimi teorik, iu përkushtua me zell lutjes së Jisuit pa pushim, detyrave dhe bindjes duke hequr dorë nga vullneti i tij dhe mbi gjithçka tjetër gjithë natën lutej dhe flinte deri një apo dy orë me intervale. Kishte mbushur vetëm tri javë në manastir, kur lutej para ikonës së Nënës së Zotit dhe lutja hyri në zemrën e tij dhe që atëherë ajo buronte vetë pa asnjë përpjekje vetjake, vazhdimisht.

Në këtë hir që Perëndia u jep zakonisht fillestarëve, pasoi një betejë e furishme kundër mendimeve ndërhyrëse nga demonët, të cilët herë-herë i thoshin se ishte shenjtor dhe herë të tjera e nxisnin në dëshpërim. Një natë qelia e tij u mbush me një dritë që shkëlqente, e cila depërtoi deri në trupin e tij, por kur ndjeu se ndjenja e pendimit e kishte braktisur, e kuptoi se u bë viktimë e iluzionit satanik.

Kaluan disa muaj dhe arriti në kulmin e dëshpërimit dhe qëndroi gjatë ulur mbi shtratin e tij i hidhëruar. Gjatë shërbesës së Mbrëmësore, ndërsa thoshte lutjen e Jisuit "Zot Jisu Krisht, Bir i Perëndisë, kij mëshirë për mua mëkatarin", duke parë ikonën e Krishtit, papritur u pushtua nga një dritë e madhe, e këndshme dhe e paqshme. Këtë herë pa Krishtin e gjallë, i cili e shikonte me butësi e gëzim, duke e mbytur gjithë qenien e tij me një dashuri që transportonte shpirtin në soditjen e Perëndisë.

Më pas shenjtori thoshte se në Frymën e Shenjtë ai kishte njohur pa asnjë dyshim vetë Zotin Jisu Krisht, i cili iu shfaq duke i bërë të njohur Hirin e Tij në gjithë përsosmërinë e Tij. Kur vizioni u zhduk, shpirti i tij pati një etje të pashuar për dashurinë e Krishtit, aq sa ditë e natë e kërkonte duke thirrur: "Shpirti im pret Zotin dhe e kërkoj Atë me lot. E si mund të mos të kërkoj? Sepse Ti i pari më gjete. Më

dhe të jetoj në Frymën e Shenjtë dhe shpirti im të dashuroi”.

Nga dëshira e tij për t’u lutur pa pushim, ai kërkoi të jetonte në Rusikonin e vjetër, një vend ky i cili varej nga manastiri dhe jetonin asketë me jetë të ashpër. Por mori një të ftohur dhe gjatë gjithë kohës vuante nga dhimbje të forta koke dhe këto i konsideronte si një ndëshkim për mosbindjen e tij. Një vit më vonë ai u thirr nga manastiri për të kryer funksionin e ikonomit. Kishte në përgjegjësi më shumë se 200 punëtorë, por kurrë nuk e la pas dore asketizmin.

Në mëngjes shkonte në punishte për të ndarë punët dhe më pas shkonte në qeli e lutej me lot për punëtorët, familjet e tyre dhe botën e tërë. Lutja e tij e zjarrtë sulmohej nga demonët, të cilët i sugjeronin mendime krenare. Luftoi me këtë luftë për gati 15 vjet, i ngushëlluar ngandonjëherë nga hiri.


Gjatë njëres prej këtyre netëve, ndërsa një demon iu shfaq para ikonës së Krishtit me qëllim që ai ta nderonte, Siluani kërkonte ndihmë tek Zoti dhe Krishti iu përgjigj me këto fjalë: “Shpirtrat krenarë vuajnë gjithmonë nga demonët”. “Cilat duhet të jenë mendimet e mia, Zot, që shpirti im të përulet?”- kërkoi Siluani. “Mbaje mendjen në ferr dhe mos u dëshpëro!”- iu përgjigj Perëndia.

Me këtë fjalë Ai i zbuloi se çdo përpjekje asketike duhet të çojë drejt përlësisë së Krishtit, i cili ka thënë: “Mësoni nga Unë, sepse jam i butë dhe i përlur nga zemra” (Mat. 11:29) dhe kjo përlësi është rruga mbretërore e cila të çon në lutjen e pastër dhe në papasionshmëri.

Që atëherë, hiri i Perëndisë banonte gjithmonë tek Siluani, duke i siguruar paqen dhe përmbajtjen e çdo lëvizje të shpirtit. Shenjti thoshte se kur e linte mendjen të dilte nga zjarri i ferrit, atëherë të gjitha mendimet merrnin fuqi dhe vinin. Me këtë dhuratë të përlësisë hyjnore, Krishti i mbushi zemrën me dashuri për të gjithë njerëzit, për Adamin e tërë dhe me lot të zjarrtë Siluani lutej pa pushim për botën, veçanërisht për të fjeturit dhe ai mësonte se kriteri bazë i njohjes së të vërtetës është dashuria për armiqtë. Lidhur me këtë, ja se çfarë shkruan: “Të lutesh për njerëzit është njësoj sikur të derdhësh gjak”.

Ky murg i përlur athonit, i cili jetoj gjithë jetën e tij në thjeshtësi, në martirizimin e të luturit për botën, i la Kishës, si një profet i ri, mesazhin e krishterë dhe rrugën e sigurt që të çon në shpëtim. Siluani e kaloi jetën e tij duke e mbajtur botën me lutje dhe duke iu përgjëruar Zotit që të gjithë njerëzit ta njihnin Atë nëpërmjet Hirit të Shpirtit të Shenjtë. Duke përfunduar vrapimin këtu në tokë, ai fjeti në paqe më 24 shtator 1938.

Image not found or type unknown



— facebook.com/koash1991